

VENDIM
Nr. 31, datë 3.11.2022¹

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Vitore Tusha	kryetare;
Marsida Xhaferllari	anëtare;
Elsa Toska	anëtare;
Altin Binaj	anëtar;
Sonila Bejtja	anëtare;
Sandër Beci	anëtar;
Illir Toska	anëtar;
Fiona Papajorgji	anëtare,

me sekretare Belma Lleshi, në datat 29.9.2022 dhe 2.11.2022 mori në shqyrtim në seancë plenare, mbi bazë të dokumenteve, çështjen nr. 7 (B) 2022 të Regjistrimit Themeltar, që u përket:

KËRKUES: Bejaze Veizaj, Tefta Veizaj, Esat Veizaj

SUBJEKTE TË INTERESUARA: Valter Veizaj, Mrika Veizaj, Violeta Veizaj, Pajtim Veizaj, Astrit Veizaj, Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Vlorë

OBJEKTI: Shfuqizimi i vendimeve nr. 752, datë 29.3.2013, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë; nr. 1158, datë 21.10.2015, të Gjykatës së Apelit Vlorë; nr. 00-2021-1694, datë 18.10.2021, të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

BAZA LIGJORE: Nenet 11, pika 2, 15, 17, 18, pika 1, 41, 42, 43, 131, pika 1, shkronja “F” dhe 134, pika 1, shkronja “I”, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; ligji nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*).

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Fiona Papajorgji, shqyrtoi parashtrimet e kërkuësve, të cilët kanë kërkuar pranimin e kërkesës, prapësimet e subjekteve të interesuara, Valter Veizaj, Mrika Veizaj dhe Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, Drejtoria Vendore Vlorë, që kanë kërkuar rrëzimin e kërkesës, konstatoi mungesën e prapësimeve me shkrim të subjekteve të tjera të interesuara, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

Rrethanat e çështjes

1. Kërkuësit Bejaze Veizaj, Tefta Veizaj dhe Esat Veizaj janë trashëgimtarë të shtetasit H. V. (gjyshi i tyre), 3 fëmijët e të cilit (baballarë të paditësve dhe të paditurve në procesin gjyqësor të kundërshtuar), pasi ai ka ndërruar jetë, kanë ndarë në tri pjesë, secila me hyrje më vete, pasurinë e paluajtshme banesë dykatëshe, e ndodhur në lagjen “Partizani” në qytetin e Vlorës, të regjistruar në emër të djalit Z.V.

¹ Saktësuar paragrafi 1 i vendimit nr. 31, datë 3.11.2022, të Gjykatës Kushtetuese, me vendimin nr. 26, datë 16.5.2023 të Gjykatës Kushtetuese, si vijon:

“Kërkuësit janë trashëgimtarë ligjorë të Z.V., ky i fundit djali i H.V. Në emër të Z.V. rezulton e regjistruar pasuria e paluajtshme banesë dykatëshe, e ndodhur në lagjen “Partizani” në qytetin e Vlorës.”

2. Subjektet e interesuara, Valter Veizaj dhe Mrika Veizaj, me pretendimin se janë bashkëpronarë të kësaj pasurie, i janë drejtuar gjykatës me kërkesëpadi me objekt detyrimin e kërkuar, si dhe të subjekteve të tjera të interesuara, Violeta Veizaj, Pajtim Veizaj, Astrit Veizaj dhe Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Vlorë (ZVRPP) (sot Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Vlorë), t'i njohin bashkëpronarë në 1/3-n pjesë të saj, si dhe detyrimin e ZVRPP-së, Vlorë të bëjë regjistrimet përkatëse për pjesën takuese të pronësisë.

3. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë, me vendimin nr. 752, datë 29.3.2013, ka vendosur: “*Pranimin pjesërisht të kërkesëpadisë. Detyrimin e të paditurve të njohin trashëgimtarët e F. V. dhe G. V. bashkëpronarë në 1/3 pjesë për secilin, në ndërtësën e cila është regjistruar në bazë të notës së transkriptimit 11, vol. XVII, viti 1953. Detyrimin e ZVRPP-së, Vlorë të pasqyrojë këto raporte pronësie në regjistrat ku figuron e regjistruar ndërtesa sipas notës së transkriptimit 11, vol. XVII, viti 1953. Rrëzimin për pjesën tjetër të kërkesëpadisë.*”.

4. Sipas dëftesës së komunikimit të administruar në dosjen gjyqësore rezulton se kërkuarit kanë marrë dijeni për vendimin e lartpërmendur në datën 1.5.2013. Kundër këtij vendimi ata kanë ushtruar ankim në datën 14.5.2013, që e kanë depozituar në sekretarinë e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë. Duke qenë se ankimi nuk është administruar në dosjen gjyqësore nga sekretaria gjyqësore, me kërkesën e kërkuarve i është dërguar me shkresën përcjellëse nr. 1441 prot., datë 16.10.2015 Gjykatës së Apelit Vlorë. Po kështu, vendimi në fjalë rezulton se është apeluar edhe nga ZVRPP-ja, Vlorë.

5. Me kërkesën e datës 20.5.2013, kërkuarit i janë drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë për ndreqjen e gabimeve në vendimin nr. 752, datë 29.3.2013, pasi kishte pasaktësi në lidhje me vërtetimin e lëshuar nga Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore Vlorë (DRSSH), si dhe për sqarimin e interpretimit të këtij vendimi, me pretendimin se ai ishte i paqartë dhe i errët.

6. Me vendimin nr. 611, datë 30.5.2013, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë ka vendosur pranimin pjesërisht të kërkesës, vetëm në lidhje me ndreqjen e gabimit, duke konstatuar pasaktësi në vendimin nr. 752, datë 29.3.2013 të po asaj gjykate. Në lidhje me kërkimin tjetër, ajo ka vlerësuar se kërkesa është e pabazuar, pasi nuk është parashtruar se në cilën pjesë vendimi është i paqartë, i errët ose konfondues. Sipas dispozitivit të këtij vendimi, ai i është bashkuar vendimit nr. 752, datë 29.3.2013, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë. Edhe ky vendim është kundërshtuar nga kërkuarit me ankimin e veçantë të datës 4.6.2013.

7. Gjykata e Apelit Vlorë, me vendimin nr. 1158, datë 21.10.2015, pasi ka marrë në shqyrtim ankimet e palëve ndërgjyqëse ndaj dy vendimeve të gjykatës së shkallës së parë, ka vendosur mospranimin e tyre, duke arsyetuar se ankimi i kërkuarit është paraqitur tej afatit të parashikuar në ligj. Nga arsyetimi i vendimit vërehet se ajo nuk ka marrë në shqyrtim ankimin mbi themelin e çështjes, por vetëm ankimin e veçantë të kërkuarve. Kundër këtij vendimi kërkuarit kanë ushtruar rekurs në Gjykatën e Lartë.

8. Me vendimin nr. 00-2021-1964, datë 18.10.2021, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë ka vendosur mospranimin e rekursit të paraqitur nga kërkuarit, pasi është bërë për shkaqe të ndryshme nga ato që parashikohen në nenin 472 të Kodit të Procedurës Civile (KPC) dhe gjykatat më të ulëta kanë respektuar ligjin material e procedural duke e interpretuar drejt atë.

9. Me kërkesën e datës 18.2.2022, kërkuarit i janë drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*) sipas objektit të saj. Me vendimin e datës 12.4.2022, Kolegji i Gjykatës ka vendosur kalimin e kësaj çështjeje për shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve.

II

Pretendimet në Gjykatën Kushtetuese

10. **Kërkuarit** kanë pretenduar, në mënyrë të përmblëdhur, se u është cenuar e drejta për një proces të rregullt ligjor, në aspektet e mëposhtme:

10.1 *Parimi i disponibilitetit*, pasi Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë ka ndryshuar bazën ligjore të padisë pa pasur një kërkesë nga palët në proces, si dhe është shprehur tej asaj që i është kërkuar në kërkesëpadi, nga njohja bashkëpronar në pjesëtim trashëgimie. Iniciativa për të filluar procesin i takon paditësit, pasi gjykata nuk procedon vetë dhe nuk merr në shqyrtim një marrëveshje nëse këtë nuk e kërkon i interesuari.

10.2 *Parimi i barazisë së armëve*, pasi Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë ka marrë në shqyrtim prova të falsifikuara, konkretisht certifikatën familjare me të cilën provohet, sipas saj, kontributi i përbashkët në blerjen e banesës, si dhe ka marrë si provë një vërtetim të lëshuar nga arkivi i DRSSH-së, Vlorë. Po kështu, gjykata ka pranuar si dëshmitare motrën e paditësit, në kundërshtim me ligjin.

10.3 *E drejta e aksesit*, pasi Gjykata e Apelit Vlorë nuk është shprehur për ankimin ndaj vendimit të themelit nr. 752, datë 29.3.2013, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, por vetëm për ankimin e veçantë ndaj vendimit nr. 611, datë 30.5.2013 të po asaj gjykate.

11. ***Subjektet e interesuara, Valter Veizaj dhe Mrika Veizaj***, kanë prapësuar si vijon:

11.1 Kërkuesit nuk legjitimohen, pasi nuk kanë shteruar mjetet juridike efektive para se t'i drejtohen Gjykatës. Për më tepër, pavarësisht se banesa objekt konflikti gjyqësor figuron në emër të xhaxhait, ajo është blerë me kontributin e përbashkët edhe të prindërve të tyre. Siç rezulton edhe nga dokumentacioni në kohën e blerjes së banesës, ata kanë qenë një trung i vetëm familjar dhe me një ekonomi të përbashkët.

11.2 Kërkuesit janë njoftuar rregullisht për zhvillimin e proceseve gjyqësore dhe kanë qenë të pranishëm në të gjitha seancat gjyqësore, me përjashtim të seancave përfundimtare ku, kanë zgjedhur me dëshirën e tyre të mos paraqiten.

11.3 Kërkuesit kanë abuzuar me të drejtën e ankimit. Abuziv është edhe pretendimi për dy dokumentet e paraqitura si prova në gjykimin e themelit, konkretisht certifikatat familjare të viteve 1950-1974 të lëshuar nga gjendja civile dhe Arkiva e Qarkut Vlorë, si dhe vërtetimi i vjetërsisë në punë i lëshuar nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore në emër të G.V.

12. ***Subjekti i interesuar, Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Vlorë***, ka prapësuar se kërkuesit nuk kanë shteruar mjetet juridike efektive, pasi ata vazhdojnë të jenë në proces gjyqësor për të njëjtën pasuri, duke kërkuar regjistrimin fillestar të pasurisë në emër të trashëgimtarëve të Z.V.

13. ***Subjektet e interesuara, Violeta Veizaj, Pajtim Veizaj dhe Astrit Veizaj***, edhe pse janë njoftuar rregullisht me shpallje nga Gjykata, nuk kanë paraqitur prapësime me shkrim.

III

Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për legjitimitimin e kërkuesve

14. Çështja e legjitimitimit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me inicimin e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “P” dhe 134, pikat 1, shkronja “I” dhe 2 të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë edhe kriteret kumulative të nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike efektive, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuar në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës.

15. Duke iu kthyer çështjes konkrete, Gjykata vlerëson se kërkuesit legjitimohen *ratione personae*, bazuar në nenet 131, pika 1, shkronja “P” dhe 134, pika 1, shkronja “I”, të Kushtetutës, pasi kanë

qenë palë në procesin gjyqësor ndaj të cilit kanë ngritur pretendime në këtë Gjykatë, për rrjedhojë provojnë interesin e tyre të drejtpërdrejtë në çështjen e parashtruar.

16. Një kriter tjetër paraprak që përcaktohet nga nenet 131, pika 1, shkronja “P” dhe 134, pika 1, shkronja “I”, të Kushtetutës, si dhe neni 71/a, pika 1, shkronja “a”, i ligjit nr. 8577/2000 ka të bëjë me *shterimin e mjeteve juridike efektive*. Për plotësimin e këtij kriteri kërkuesi duhet të shfrytëzojë në rrugë normale mjetet juridike efektive, të cilat janë të përshtatshme, të disponueshme dhe të frytshme për një çështje konkrete. Shterimi i mjeteve përbën parakusht që duhet përmbushur nga kërkuesi, i cili para se t’i drejtohet Gjykatës duhet të vërtetojë se ka përdorur të gjitha mjetet juridike të njohura nga ligji dhe të mjaftueshme për të rivendosur të drejtat e shkelura. Mjetet juridike shterojnë kur, në varësi të rrethanave të çështjes, rregullat procedurale nuk parashikojnë mjete të tjera ankimi (*shih vendimin nr. 38, datë 25.4.2017, të Gjykatës Kushtetuese*). Nga ana tjetër, duhet theksuar se bëhet fjalë për shterimin e mjeteve juridike efektive, pra të atyre mjeteve që janë të afta për të rivendosur të drejtën që pretendohet se është shkelur (*shih vendimet nr. 2, datë 17.2.2022; nr. 38, datë 2.12.2021; nr. 31, datë 4.10.2021, të Gjykatës Kushtetuese*).

17. Ky rregull nënkupton jo vetëm që individ i t’u jetë drejtuar të gjitha instancave të zakonshme, por edhe që të gjitha pretendimet që ngre në këtë Gjykatë t’i ketë paraqitur më parë në këto instanca, të paktën në substancë, duke respektuar kërkesat formale dhe afatet e parashikuara në ligjin procedural (*shih vendimin nr. 15, datë 7.5.2018, të Gjykatës Kushtetuese*). Prandaj, shkelja e të drejtave kushtetuese mund të pretendohet në këtë Gjykatë vetëm pas ezaurimit të të gjitha mundësive që ofron sistemi i padive dhe i apeliemeve (*shih vendimet nr. 45, datë 1.11.2013; nr. 10, datë 9.5.2005; nr. 10, datë 2.4.2003, të Gjykatës Kushtetuese*).

18. Subjektet e interesuara, Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Vlorë, Valter Veizaj dhe Mrika Veizaj, kanë prapësuar se kërkuesit nuk kanë shteruar mjetet juridike, pasi ata vazhdojnë të jenë në proces gjyqësor për të njëjtën pasuri, duke kërkuar regjistrimin fillestar të pasurisë në emër të trashëgimtarëve të Z.V.

19. Gjykata vlerëson se prapësimi i subjekteve të interesuara është i papabazuar, pasi ekzistenca e proceseve të tjera gjyqësore për të njëjtën pasuri nuk e kushtëzon kontrollin kushtetues të procesit gjyqësor të kundërshtuar, kur ai cenon të drejtat kushtetuese të individit për sa kohë ka përfunduar në të tria shkallët e gjykimit dhe për të cilin është dhënë edhe një vendim përfundimtar nga Gjykata e Lartë.

20. Po në këndvështrim të verifikimit të përmbushjes së këtij kriteri, Gjykata vëren se shkaqet e parashtruara në rekurs nga kërkuesit janë bazuar në arsyetimin e vendimit të Gjykatës së Apelit Vlorë, që nuk ka shqyrtuar ankimin e tyre për themelin e çështjes, por është mjaftuar vetëm me vlerësimin e ankimit të veçantë, duke e konsideruar atë si të paraqitur jashtë afatit ligjor. Ato janë të lidhura me të drejtën e aksesit në gjykatë, si dhe për të marrë përgjigje përfundimtare në lidhje me pretendimet e parashtruara në ankim, prandaj konsiderohet se ata i kanë shteruar mjetet juridike efektive.

21. Për sa i takon legjitimitetit *ratione temporis*, bazuar në nenin 71/a, pika 1, shkronja “b”, të ligjit nr. 8577/2000, afati për paraqitjen e ankimit kushtetues individual është 4 muaj nga konstatimi i cenimit të së drejtës. Nga aktet bashkëlidhur kërkesës rezulton se procesi gjyqësor i kundërshtuar nga kërkuesit ka përfunduar me vendimin nr. 00-2021-1694, datë 18.10.2021, të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, kurse kërkesa në Gjykatë është regjistruar fillimisht në datën 18.2.2022, si kërkesë e paplotë dhe, më pas, pas plotësimit të dokumentacionit të kërkuar, në datën 2.3.2022. Sipas pikës 2 të nenit 31 të ligjit nr. 8577/2000, kur kërkesa paraqitet e plotësuar brenda afatit, si datë e paraqitjes së saj konsiderohet data e paraqitjes për herë të parë në Gjykatë. Për rrjedhojë, duke konsideruar datën 18.2.2022 si datë të paraqitjes së kërkesës, nga e cila fillon të llogaritet edhe afati ligjor 4-mujor i paraqitjes së ankimit kushtetues individual, kërkuesit legjitimohen *ratione temporis* për vënien në lëvizje të juridiksionit kushtetues.

22. Për sa i takon legjitimitetit *ratione materiae*, Gjykata konstaton se kërkuesit kanë pretenduar cenimin e parimit të disponibilitetit, të barazisë të armëve dhe të së drejtës së aksesit në gjykatë, të cilat kanë natyrë kushtetuese, ndaj do të merren në shqyrtim në vijim.

B. Për themelin e pretendimeve

B.1. Për cenimin e së drejtës së aksesit

23. Kërkuesit kanë pretenduar se Gjykata e Apelit Vlorë u ka cenuar të drejtën e aksesit në gjykatë, sepse ata kanë marrë dijeni për vendimin (e themelit) nr. 752, datë 29.3.2013, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë më 1.5.2013, datë nga e cila u ka lindur e drejta dhe u ka filluar afati për të paraqitur ankim. Edhe pse ky ankim është depozituar në sekretarinë e asaj gjykate më 14.5.2013 dhe është paguar tarifa përkatëse, ai nuk është administruar në dosjen gjyqësore nga sekretaria gjyqësore. Vetëm pas kërkesës së kërkuesve ai i është dërguar me shkresë përcjellëse Gjykatës së Apelit Vlorë. Ndërkohë, kjo gjykatë nuk është shprehur për ankimin ndaj vendimit të themelit, por vetëm për ankimin e veçantë të ushtruar ndaj vendimit për ndreqjen e gabimeve.

24. Sipas subjekteve të interesuara, Valter Veizaj dhe Mrika Veizaj, kërkuesit janë njoftuar rregullisht për zhvillimin e proceseve gjyqësore dhe kanë qenë të pranishëm në të gjitha seancat gjyqësore, me përjashtim të seancave përfundimtare ku kanë zgjedhur me dëshirën e tyre të mos paraqiten, duke abuzuar me të drejtën e ankimit.

25. Në nenin 42, pika 2, të Kushtetutës parashikohet se kushdo, për mbrojtjen e të drejtave, të lirive dhe interesave të tij kushtetuese dhe ligjore, ka të drejtën e një gjykimi të drejtë dhe publik brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme e caktuar me ligj. Kjo dispozitë sanksionon të drejtën për gjykim, ku e drejta e aksesit, që është e drejta për të vënë në lëvizje gjykatën, përbën një aspekt të saj. Në jurisprudencën kushtetuese është theksuar se e drejta e aksesit u garanton subjekteve të cenuara të drejtën t'i drejtohen një gjykate, e cila do t'i dëgjojë pretendimet e tyre dhe do të shpallë një vendim pas një gjykimi të drejtë dhe publik. Kjo e drejtë e individit nuk përfshin vetëm të drejtën për të vënë në lëvizje gjykatën, por edhe të drejtën për të pasur prej saj një zgjidhje përfundimtare për mosmarrëveshjen objekt gjykimi, pasi aksesit në gjykatë duhet të jetë substancial dhe jo thjesht formal (*shih vendimet nr. 5, datë 22.2.2022; nr. 22, datë 29.4.2021; nr. 3, datë 23.2.2016, të Gjykatës Kushtetuese*).

26. Administrimi i mirë i drejtësisë fillon me garancinë që një individ të ketë akses në gjykatë për t'i siguruar atij të gjitha aspektet e një forme gjyqësore të shqyrtimit të çështjes. Në rast se mohohet kjo e drejtë procesi konsiderohet i parregullt, sepse aksesit në gjykatë është, para së gjithash, një kusht kryesor për të realizuar mbrojtjen e të drejtave të tjera të individit. Shteti i së drejtës nuk mund të konceptohet pa u njohur individëve të drejtën dhe mundësinë për t'iu drejtuar gjykatës (*shih vendimet nr. 19, datë 1.4.2021; nr. 3, datë 23.2.2016; nr. 52, datë 14.11.2014, të Gjykatës Kushtetuese*). Po në këtë drejtim, Gjykata ka theksuar se e drejta e ankimit, ashtu si edhe ajo e aksesit në gjykatë, nuk mund t'i cenohen kërkuesit për shkaqe që rrjedhin nga mangësitë ose gabimet në veprimtarinë e vetë organeve shtetërore (*shih vendimet nr. 6, datë 22.2.2022; nr. 5, datë 2.3.2011; nr. 22, datë 26.7.2006, të Gjykatës Kushtetuese*). Nga ana tjetër, e drejta për të pasur akses në gjykatë i garanton individit të drejtën për t'iu drejtuar gjykatës dhe për të marrë një përgjigje përfundimtare prej saj lidhur me pretendimet e ngritura. Funkcioni i një vendimi të arsyetuar është t'u tregojë palëve se ato janë dëgjuar, si dhe u jep mundësinë atyre ta kundërshtojnë atë (*shih vendimet nr. 13, datë 9.3.2021; nr. 67, datë 10.11.2017, të Gjykatës Kushtetuese*).

27. Gjykata ka pohuar se rregullat që disiplinojnë hapat formalë për paraqitjen e një ankimi, synojnë të sigurojnë miradministrimin e drejtësisë. Thelbi i së drejtës së aksesit në gjykatë cenohet kur rregullat procedurale pushojnë së shërbyeri qëllimit të administrimit të duhur të drejtësisë dhe formojnë një lloj pengese që pengon palën ndërgjyqëse që çështja e tij/saj të vendoset në themel nga gjykata kompetente. Në veçanti, çështja e administrimit të duhur të drejtësisë është element kryesor për të bërë dallimin midis formalizmit të tepruar dhe zbatimit të pranueshëm të formaliteteve procedurale. Në shqyrtimin e proporcionalitetit të një kufizimi të aksesit në gjykatë, duhet të merren

parasysh gabimet procedurale të kryera gjatë procedurave, të cilat i penguan kërkuesit të gëzonin një akses të tillë dhe përcakton nëse kërkuesit ishin detyruar të mbanin një barrë të tepruar për shkak të këtyre gabimeve. Aty ku janë bërë gabime para gjykatave më të ulëta, Gjykata e Lartë duhet të luajë rolin e saj (*shih vendimin nr. 6, datë 22.2.2022, të Gjykatës Kushtetuese*).

28. Në rastin në shqyrtim, Gjykata konstaton se nga aktet e depozituara nga kërkuesit, si dhe ato në dosjen gjyqësore, të administruara për nevoja të këtij gjykimi kushtetues, rezulton se ata kanë paraqitur ankimin e datës 14.5.2013 ndaj vendimit nr. 752, datë 29.3.2013, të Gjykatës së Rrethit Vlorë, që ka shqyrtuar themelin e çështjes, ashtu dhe ankimin e veçantë të datës 4.6.2013 ndaj vendimit nr. 611, datë 30.5.2013 të po asaj gjykate, i cili është shprehur për kërkesën e tyre për ndreqjen e gabimit dhe interpretimin e vendimit nr. 752, datë 29.3.2013.

29. Gjithashtu, vërehet se ankimi kundër vendimit të gjykatës së shkallës së parë që ka shqyrtuar themelin e çështjes nuk rezulton të jetë administruar nga ajo gjykatë në dosjen gjyqësore që i përket këtij procesi. Ndërkohë në dosje janë të administruara dëftesat e komunikimit të këtij ankimi për palët e tjera ndërgjyqëse. Edhe sipas shkresës nr. 1441 prot., datë 16.10.2015, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, drejtuar kërkuesit Esat Veizaj, rezulton: *“Nga verifikimi i kryer në nëndosje rezulton se nga ana e sekretarisë së gjykatës në kohën e dërgimit të dosjes në gjykatën e apelit është harruar pa u kapur ankimi original i paraqitur më datë 14.5.2013 nga palët Bejaze Veizaj, Tefta Veizaj dhe Esat Veizaj kundër vendimit nr. 752, datë 29.3.2013, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë. Pas konstatimit të këtij fakti, nga ana jonë u morën masa për dërgimin e këtij ankimi pranë Gjykatës së Apelit Vlorë.”*. Gjykata konstaton, po ashtu, se me shkresën nr. 1441 prot., datë 16.10.2015, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë i ka dërguar Gjykatës së Apelit Vlorë: *“ankimin original të paraqitur në 14.5.2013 nga palët Bejaze, Tefta dhe Esat Veizaj kundër vendimit nr. 752, datë 29.3.2013”*. Sipas kësaj shkrese: *“ky ankim rezulton të jetë harruar pa u kapur në dosjen gjyqësore...”*.

30. Në vijim të shkresës së datës 13.5.2022 të drejtuar nga Gjykata për qëllime të këtij gjykimi, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë, me shkresën nr. 5032/1 prot., datë 24.5.2022, ka sqaruar se në dosjen civile nr. 752, datë 29.3.2013 mungonte ankimi original i kërkuesve në lidhje me këtë vendim dhe se ai, pas konstatimit të këtij fakti, i është dërguar Gjykatës së Apelit me shkresën nr. 1441, datë 16.10.2015. Ky fakt konfirmohet edhe nga Gjykata e Apelit Vlorë, e cila me shkresën nr. prot., 812/2, datë 2.11.2022, në përgjigje të informacionit të kërkuar nga Gjykata, ka pohuar se në *“Regjistrin e Korrespondencës së vitit 2015 të Arkivit të Gjykatës së Apelit Vlorë”* figuron i protokolluar me nr. 728, prot., datë 20.10.2015 ankimi i paraqitur nga Bejaze Veizja, Tefta Veizaj dhe Esat Veizaj. *Ankimi është dërguar prej Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë”*.

31. Gjykata konstaton se në Gjykatën e Apelit Vlorë çështja gjyqësore, ku kërkuesit kanë qenë palë ndërgjyqëse, është shqyrtuar në seancën gjyqësore të datës 21.10.2015, pra pasi Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë kishte dërguar ankimin ndaj vendimit të themelit (datë 16.10.2015). Në këtë seancë kërkuesit kanë qenë në mungesë, ndërkohë që përfaqësuesi i paditësve ka kërkuar mospranimin e ankimit. Duke qenë se vendimi nr. 611, datë 30.5.2013 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë (për ndreqje gabimi) i është bashkuar vendimit nr. 752, datë 29.3.2013 të po asaj gjykate, Gjykata e Apelit Vlorë ka shqyrtuar ankimet e palëve ndërgjyqëse (kërkuesve dhe ZVRPP-së) për të dyja vendimet e lartpërmendura (*shih paragrafët nr. 4 dhe nr. 7*).

32. Me vendimin nr. 1158, datë 21.10.2015, Gjykata e Apelit Vlorë ka vendosur mospranimin e ankimeve të kërkuesve dhe ZVRPP-së, Vlorë. Në pjesën hyrëse të vendimit, në lidhje me ankimin ndaj vendimit të themelit, gjykata e apelit shprehet: *“Kundër vendimit kanë paraqitur ankim në datën 4.6.2013, të paditurit Esat veizaj dhe Tefta Veizaj, të cilët kërkojnë prishjen e vendimit dhe pushimin e çështjes...”*, kurse referuar pjesës arsyetuese të këtij vendimi rezulton, se: *“ankimi është paraqitur tej afatit të parashikuar në ligj dhe për këto arsye vendoset mospranimi i ankimit. Në nenin 443 të KPC-së parashikohet se afati i ankimit në gjykatën e Apelit, kundër vendimeve përfundimtare të gjykatës së shkallës së parë është 15 ditë. Provohet që pala ankuese ka marrë dijeni për vendimin, e paditura Tefta Veizaj në datën 1.5.2013, sipas dëftesës së komunikimit datë 23.4.2013, kurse i padituri Esat Veizaj në datën 23.4.2013. Bazuar në nenin 444 të KPC-së*

afati i parashikuar në nenin 443 të cituar më lart, fillon nga dita e nesërme e marrjes dijeni për vendimin përfundimtar. Rezulton se afati i parashikuar në nenin 443 të KPC-së ka përfunduar në datën 16.5.2013, ora 16. Nga ankimi rezulton e provuar që ai është paraqitur në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Vlorë në datën 4.6.2013, pra tej afatit të parashikuar në ligj.”.

33. Bazuar në sa më sipër, ankimi ndaj vendimit të shkallës së parë që ka zgjidhur çështjen në themel, pavarësisht se i është dërguar Gjykatës së Apelit Vlorë përpara datës së shqyrtimit, nuk i është dërguar për administrim trupit gjykues që shqyrtonte çështjen. Prandaj, Gjykata e Apelit Vlorë në shqyrtimin e çështjes i është referuar vetëm ankimit të veçantë të paraqitur nga kërkuesit ndaj vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë nr. 611, datë 30.5.2013. Ajo nuk kishte mundësi të shprehej dhe as të merrte në shqyrtim ankimin e kërkuesve për vendimin nr. 752, datë 29.3.2013.

34. Për sa më lart, duke i vlerësuar veprimet/mosveprimet e konstatuara në procesin gjyqësor në drejtim të garantimit të së drejtës së aksesit në gjykatë, rezulton se për shkak të pakujdesisë së administratës gjyqësore, e cila e ka dërguar me vonesë ankimin e kërkuesve në lidhje me vendimin e themelit të çështjes, ai nuk i është bashkëlidhur dosjes gjyqësore dhe, për rrjedhojë, nuk është marrë në shqyrtim nga gjykata e apelit. Me fjalë të tjera, edhe pse sekretaria e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, e vënë në lëvizje nga kërkuesit, e ka dërguar ankimin në gjykatën e apelit, nuk rezulton që ai të jetë administruar në dosjen gjyqësore dhe të jetë marrë në shqyrtim nga trupi gjykues që ka shqyrtuar çështjen në gjykatën e apelit.

35. Fakti i lartpërmendur është parashtruar nga kërkuesit edhe në shkaqet e rekursit të paraqitur në Gjykatën e Lartë, por, kjo e fundit, me vendimin nr. 00-2021-1694, datë 18.10.2021, ka vendosur mospranimin e tij me arsyetimin se është bërë për shkaqe të ndryshme nga ato që parashikohen në nenin 472 të KPC-së dhe se gjykatat më të ulëta e kanë respektuar ligjin material dhe procedural duke e interpretuar drejt atë. Në këtë mënyrë, Gjykata e Lartë, duke mos u shprehur në lidhje me këtë pretendim të kërkuesve, nuk u ka dhënë atyre përgjigje përfundimtare dhe të arsyetuar për shkaqet e ngritura në rekurs, edhe pse ato lidhen në mënyrë të drejtpërdrejtë me garantimin e së drejtës për proces të rregullt ligjor.

36. Bazuar në këto konsiderata, Gjykata vlerëson se janë pikërisht mangësitë ose gabimet e administratës gjyqësore që kanë shkaktuar mosshqyrtimin në gjykatën e apelit të ankimit ndaj vendimit të shkallës së parë të paraqitur nga kërkuesit. Edhe Gjykata e Lartë, në funksion të rolit të saj subsidiar, nuk e ka riparuar situatën, edhe pse gjendej përpara një pretendimi me natyrë kushtetuese. Për rrjedhojë, Gjykata çmon se pretendimi i kërkuesve për cenimin e së drejtës së aksesit në gjykatë është i bazuar.

37. Gjykata në jurisprudencën e saj ka theksuar qëndrimin se kontrolli i respektimit të standardeve kushtetuese për një proces të rregullt ligjor është funksion edhe i gjykatave të zakonshme dhe se raportet ndërmjet juridiksionit kushtetues dhe juridiksionit të gjykatave të zakonshme udhëhiqen nga parimi i subsidiaritetit (*shih vendimet nr. 6, datë 16.2.2021; nr. 45, datë 3.7.2017, të Gjykatës Kushtetuese*). Në vështrim të standardeve të mësipërme, Gjykata çmon se vendimet nr. 1158, datë 21.10.2015, të Gjykatës së Apelit Vlorë dhe nr. 00-2021-1964, datë 18.10.2021, të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë duhet të shfuqizohen dhe çështja duhet të dërgohet për shqyrtim në Gjykatën e Apelit Vlorë ku ka ndodhur shkelja, për shkak të mosshqyrtimit të ankimit të kërkuesve. Për më tepër, kjo e fundit, duke u bazuar në kompetencat e saj si gjykatë ligji dhe fakti, është në pozicionin e duhur për të shqyrtuar pretendimet e kërkuesve të ngritura në ankim dhe për t’iu dhënë përgjigje të arsyetuar atyre në respektim të standardeve kushtetuese. Në vijim, Gjykata vlerëson të mos ndalet në analizimin e pretendimeve të tjera të kërkuesve, që kanë të bëjnë me cenimin e parimit të disponibilitetit dhe të barazisë së armëve, sipas tyre, të cenuara gjatë procesit në shkallën e parë, për sa kohë që çështja do të merret sërish në shqyrtim nga Gjykata e Apelit Vlorë.

38. Në përfundim, Gjykata vlerëson se pretendimi i kërkuesve për cenimin e së drejtës së aksesit është i bazuar dhe duhet të pranohet sipas arsyetimit të mësipërm.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të neneve 131, pika 1, shkronja “F” dhe 134, pika 1, shkronja “I”, të Kushtetutës, si dhe neneve 72 e vijues të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, njëzëri,

VENDOSI:

1. Pranimin pjesërisht të kërkesës.
 2. Shfuqizimin e vendimit nr. 1158, datë 21.10.2015, të Gjykatës së Apelit Vlorë dhe vendimit nr. 00-2021-1964, datë 18.10.2021, të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë.
 3. Dërgimin e çështjes për rishqyrtim në Gjykatën e Apelit Vlorë.
- Ky vendim është përfundimtar dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Marrë më 3.11.2022.

Shpallur më 1.12.2022.

Kryetare: Vitore Tusha

Anëtarë: Elsa Toska, Marsida Xhaferllari, Sandër Beci, Sonila Bejtja, Altin Binaj, Fiona Papajorgji, Ilir Toska